



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES URGJENTE TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 31.03.2020 (e martë), në Shkollën e Mesme Teknike “Januz Zejnullahu” në Viti, duke filluar me punë në ora 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, mediat elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Mirëdita e mire se keni ardhur në seancën urgjente të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndet nënkryetarin z.Hasan Aliu, juve këshilltar të Kuvendit Komunal. Këtë seancë e kam thirrur në konsultim me grupin parlamentar. Unë e qes në votim pikën e rendit të ditës dhe kërkoj nga të gjithë që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Fillimisht me lejoni që t’i falënderoj infermieret, mjekët, policinë, e të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë, për respektimin e rekomandimeve që po dalin nga Instituti Shëndetësor. Gjithashtu i falënderoj edhe të gjithë donatorët që po ndihmojnë për kalimin e kësaj situatë.

Për këtë seancë kemi këtë rend dite:

#### **1. Njoftim për këshilltarët e Kuvendit Komunal të Vitisë, për punën rreth pandemisë së Covid -19, dhe shqyrtimin, miratimin e propozimit vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për këtë destinacion**

Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës me ngritje dore? Konstatohet se me votat e të gjithëve u miratua pika e rendit të ditës për këtë seancë urgjente.

**z.Hasan Aliu Nënkryetar i Komunes:** Përshëndetje të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, drejtor të drejtorive që jeni prezent, ju media elektronike. Kjo seancë është thirrur me kërkesën e kryetarit të komunës, së bashku me shefat e grupeve parlamentare. I përshëndes edhe epikën mjekësore që janë prezent këtu, të cilët janë ballafaquar në aspektin e tyre profesional, pa u kursyer në 24 ore me gjendjen që e kaploj edhe Komunën e Vitisë. Të nderuar këshilltar të kuvendit komunal! Po konsideroj se nga seanca e fundit të cilën e kishim sikur i paraprishim ndoshta edhe kësaj seance, sepse edhe ajo seancë ishte seancë e jashtëzakonshme, por e natyrës diçka krejt tjetër dhe pikërisht me të njëjtën ditë me 12.03, me iniciativë të kryetarit është mbajtur edhe mbledhja e Këshillit të Drejtorëve, e zgjeruar, që kanë qenë të njoftuar edhe shefat e grupeve të këshilltarëve të Kuvendit Komunal, komandanti i Policisë, që i kemi paraprirë situatës e cila nga ana e UBSH-së u shpall si pandemi e nivelit botëror dhe nga qeveria e kishim edhe sugjerimet e mëtutjeshme, se çka duhet të ndërmerret komuna. Ne e kishim të formuar qendrën operative të cilën e kemi aktivizuar dhe e formuam edhe komitetin për mbrojtjen dhe shpëtimin, komitet të cilën e kryesonte kryetari i komunës, ndërsa anëtar janë anëtar të qeveris komonale dhe qyshe me datën 13 në formimin e këtij komiteti rezultoi edhe pacienti i parë në nivel të Republikës së Kosovës, që ishte nga Komuna e Vitisë, gjerësisht nga Stublla, që u diastifikua si pozitiv, me

çka të nesërmen edhe anëtarët të tjerë të familjes dhe numri është rrit në 7 anëtar. Ne si komitet bëmë përpjekje po në të njëjtën ditë, dikune ne ora 18:00, në takimim e mbajtur të komitetit, që si komitet komunal t'i ndërmarrim të gjitha ato masa të cilat janë në domenin tonë, të bimë një vendim për izolim të lokalitetit të Stubelles dhe që situatën ta kemi në kontroll dhe të fillojmë t'i marrim kontaktet me të gjithë ata njerëz apo familjar të cilët i diagnozifikuan. Ka pas mundësi të jetë në kontakt me ata persona, dikun në mbrëmje. Jeni dëshmitar të asaj, se Qeveria e Republikës së Kosovës bien vendim të cilën jo vetëm Stubllen, po e bën izolimin e krejt Komunës së Vitisë, me çka na si pushtet lokal kemi qenë të obliguar të zbatojmë. Fillimisht jemi ballafaqu me probleme të mdhaja, duke filluar që nga pajisjet të cilat ishin të mangëta, si për stafin mjekësor, njësinë e policisë, shërbimin e zjarrfikësve, të gjithë ata të cilët ishin në vijën e parë të frontit, që janë ballafaqu me të diagnozifikuarin. Ne në vazhdimësi bëjmë kërkesa të vazhdueshme në drejtim të Qeverisë, po edhe në adresë të njerëzve të cilët janë të vullnetit të mirë, që konsideroj që kemi pas mirëkuptimin e tyre, që vlen me i falenderu të gjithë ata të cilët në ato ditët e para bënë përpjekje maksimale të jenë pranë qytetarëve të Komunës së Vitisë, pranë ekipeve të cilët ishin aktiv në punën prej QKMF-së, njësisë së zjarrfikësve, shërbimit policor dhe ja dolëm disi të pajisem edhe me rroba mbrojtëse dhe me maska, sidomos për personat të cilët janë kanë në vijën e parë të frontit të luftimi të saj epidemie që bëmë përpjekje maksimale ta kemi në kontroll. Menjëherë me datën 14 është dita e dytë e diagnozifikimit dhe ardhja e tendës në oborrin e QKMF-së në Viti, vendosja e saj, që mundësisht të gjithë ata që kanë simptome të virusit të Covid 19, mos të depërton në QKMF, e ku mund të shkas për përhapjen edhe të personelit shëndetësor edhe të personave të tjerë që e vizitojnë QKMF-në. Ajo që ka qenë me brengosëse, që eshët dashtë një angazhim i madh, sepse pikërisht me 13 na ka rezultu edhe me izolimin e 15 punëtorëve shëndetësor, të cilët në mënyrë direkte apo indirekte është kanë mundësia e infektimit me personin, i cili është diagnozifiku, tu e pas parasysh gjithëherë sipas informacioneve te drejtoreshës dhe drejtorit të shëndetësisë, dhe tre që kanë qenë me sëmundje kronike e kane përjashtu nga puna të jenë aktiv. Ato ditë numri i atyre që nuk janë kanë punëtor shëndetësor, u rrit në 18, por megjithatë edhe në ato situata brenda pak kohe janë lajmëru shumë mjek e motra teknike medicinale vullnetar, të cilët kanë shpreh gatishmërinë në ato raste, që t'i bashkëngjiten ekipit mjekësor në Viti dhe t'i ndihmojnë në rast se gjendja e popullatës së Komunës së Vitisë është përhap virusi me tepër se 7 te identifikuarve. Në ato momente, ka qenë një koordinim shumë i mirë edhe i komitetit. Vlen me theksu dhe me i falenderu edhe komitetin stublas, në kry me kryetarin këshillit të fshatit, me drejtorin e shkollës, të cilët pandërpre janë kanë në lidhje të vazhdueshme me ne dhe kanë mirëkuptua edhe vendimi e karantinizimit të cilët e kanë respektu deri me sot, që jemi në ditën e 18, me çka po kalon kjo ditë dhe asnjë rast tjetër deri me sot nuk e kemi të diagnostifikuar. Kjo d.m.th, se luftën me të madhe ata të cilët mujn me bë me përhapjen e kësaj s'mundje, janë vet popullata, të cilët tu i respektu këshillat e mjekëve, duke i respektu këshillat institutit, tu e mbajt distancën sociale dhe higjienën, të gjitha ato nëse i përmbahemi, unë besoj dhe shpresoj se do ta kalojmë në formën me të mirë të mundshme. Këtij falënderimi, përveç stubllasve, ju takon edhe qytetarëve të Komunës së Vitisë, të cilët me të vërtetë kanë qenë për çdo lakmi dhe respektim të kësaj vlen me i falenderu pavarësisht distancës edhe shefat e grupeve të këshilltarëve të kuvendeve komunal të cilët përmes mjeteve telefonike, çdo herë kanë shpreh gatishmërinë me ardh me ju bashkëngjit dhe me na ndihmu në këtë situatë. Po të njëjtën ditë, e kam fjalën për datën 12.13, ne kemi mbajt edhe mbledhjen e këshillit organizativ. Ju jeni dëshmitar që në mujin mars e kemi "Flakadanin e Karadakut", që u dash ne përputhjen me vendimet e qeverisë me dal me një vendim lidhur me anulimin e "Faladakut të Karadakut", të cilën e kemi pas edhe mirëkuptimin edhe nga anëtarët e familjes, të cilët me mirëkuptim të plotë e kemi anul, ndërsa vetëm me datën 26 kemi bë homazhe për mos me e harru "Komandant Mjekrrën". Pas kësaj, që në start kanë fillu edhe lista e donatorëve, ndihma e parë që e ka ofru ka qenë fondacioni "Labi", i cili fillimisht me 1000 maska e ka nderu Komunën e Vitisë dhe të nesërmen me 300 copa që kanë qenë të identikuara për stubllasit, kemi ndërmarr masat. Menjëherë të njëjtën dite me 14 dhe nuk po me kujtohet kompania nga Ferizaji, si fillim ka shpreh gatishmërinë që me ardh në Viti me e bë dezinfektimin e disa objekteve falas, derisa në konsultim me ministrinë, ne i kemi udhëheq procedurat të cilat në këto raste lejohen edhe në procedurë të shpejtë, me çka e kemi udhëheq, e kemi përzgjedh kompaninë dhe ka fillu dezinfektimi, tu fillu prej Stublles, objektet fetare, vendet me të frekuentuara, stacionin e autobusëve. Përveç kësaj, ndoshta në këtë seancë, është shume me rendësi për ju këshilltar të nderuar, edhe lista e donatorëve ka qen bukur e gjatë. Unë i falënderoj të gjithë. Vlen me theksu njerëzit të cilët kanë përfitu si ndihmë, si në mill

apo pako ushqimore, gjana elementare që i nevojiten një familje. Tash kalon numrin mbi 1200, që konsideroj që përveç asaj që e kemi si asistencë sociale, që sillet numri i tyre dikun rreth 500 e kemi arrit me e tejkalu, për shkak se jemi qytetar të Komunës së Vitisë dhe e dimë se të gjithë ata të cilët kanë punu ne ndërtimtari apo ne forma tjera, këto dite është ndal puna dhe edhe ata pavarësisht që nuk janë në asistencë sociale, kanë nevojë për shtrirjen e dorës së ndihmës dhe t'i ndihmojmë deri sa të tejkalojmë këtë situatë. Po konsideroj se ne këtë adresë shumë prej donatorëve të cilët janë lajmëru dhe po lajmërohen vazhdimisht për çdo ditë, besoj që së bashku do të tejkalojmë edhe këtë situatë. Nuk kanë mungu kontaktet e vazhdueshme dhe kontrollet nga ekipi mjekësor me në krye, konsideroj gjithëherë me epidemiologun të cilin e kemi këtu prezent, të cilin e falënderoj z.Ismajl Bekteshi. I falënderoj edhe kryetarët e këshillave të fshatrave, të cilët në koordinim me koordinatorin e kanë krye punën në mënyrën shume të mirë, të cilët të gjitha ato familje që kanë pas ardhje nga shtete jashtë Kosove, i kemi rekomandu që të vetizohen dhe që ekipi mjekësor nga QKMF-ja ka qenë rregullisht në kontroll të këtyre, në gjendje shëndetësore se si po lëvizin. Në vazhdimësi kemi qenë në çdo mëngjes me informacione edhe me qendrën regjionale epidemiologjike të Gjilanit, të cilët i falënderojmë. Me datën 14 e kishim edhe vizitën nga eksperti i kësaj lëmie, Lul Raka, i cili i vizitoj komitetin tonë në Viti dhe i cili i dha sugjerimet të para të distancës sociale dhe pastërtinë të cilët krejt këto. Ne edhe përmes rrjeteve sociale dhe televizionit u mundum që t'i plasojmë deri tek të gjithë qytetarët që të janë të njoftuar lidhur me këtë. Me 16.03, Komunën e Vitisë e vizitoj edhe ministrja e MAPL-së, me të cilin takim i treguam edhe vështirësitë me të cilën po përballemi dhe punën të cilën e kemi bë si komune dhe kërkuam të gjitha ato nevoja të cilat i kishim megjithatë pa dash me e akuzu kërkan, ndihma nga ana e ministrive ka qenë shumë e vogël dhe shumë simbolike. Ne i kemi të identifikuar të gjitha ato të cilat kërkesa, ku i kemi shtrur që popullata e Komunës së Vitisë, ka nevojë për to ndoshta ende nuk kemi sugjerime, po megjithatë tu e pas parasysh një provoj bukur të gjatë timen, ndoshta në përfundim të krejt të kësaj, ndoshta faturat të cilat i kemi bë, shpenzimet, këto kohe do t'i mbulojmë, megjithatë asnjë informacion rreth kësaj deri me tani nuk e kemi, po megjithatë ne sot nuk jemi me i kritiku, po jemi me i falenderu të gjitha ata që po bëjnë përpjekje dhe me ju thanë edhe juve që edhe në ditët ne vijim. Ky seriozitet i këtyre ditëve, unë besoj që do të vazhdohet deri sa me të vërtet këtë epidemi ta çrrënjosmi dhe që thashtë Zoti me lutjen e fundit, që në Komunën e Vitisë, e mbarë popullit njerëzor, që ta kalojmë këtë epidemi. Këshilltar të nderuar, aktiviteti i juaj këto ditë dhe zëri i juaj, këto e mbulojnë krejt Komunën e Vitisë ju kisha lut ju që ata të cilën po e thojn institucionet profesionale ta plotësojmë te qytetaret te rrethi familjar tek zgjerimi nga vendi ku vimë dhe me të vërtet të rumi edhe këto 2 jav sipas eksperteve që po thojnë janë jetik. Duke ju falenderu të gjithëve për kontributin gjatë këtyre ditëve, e falënderoj edhe shoqatën e Kryqit të Kuq dhe Nënë Tereze, që janë në aktivitet pandërpre dhe të gjitha atyre që po kontribuoni. Unë që nga dita e parë që kam kontakt me komandantin e stacioni policor të Vitisë, të gjithë ju këshilltar komunal ku e keni lejen e lëvizjes brenda Komunës së Vitisë pa problem.

**z.Ali Bajrami;** Faleminderit kryesues për fjalën e dhënë! Nënkryetar, të falënderojmë për njoftimin e punëve që është bë, rreth pandemisë Covi 19 në Komunën e Vitisë. U pa që është bë një punë e mirë, një angazhim shumë i madh, duke u bazuar në Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Vitisë, kompetencat ligjore si kryetar i komunës, kemi propozim vendimin nga kryetari i komunës, duke u dakorduar edhe me shefat e grupeve parlamentare, po edhe me këshilltarët komunal që nuk kanë grup parlamentar, kemi këtë propozim vendim për ndarjen e shumës së mjeteve, që është cekur në propozim vendim. Si grup parlamentar i LDK-së jemi pro këtij propozim vendimi.

**Drejtori z.Ibrahim Rama:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Duke u bazuar në situatën e krijuar pas kësaj pandemie, që ka të bëj me shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, kryetari i komunës në konsultim me qeverinë komunale kemi ardh në përfundim, që t'i propozojmë kuvendit komunal një propozim vendim për këtë situat emergjente, që ka të bëj me këtë epidemi, duke u bazuar në vendimet e Qeveris së Republikës së Kosovës për menaxhimin e situatave emergjente të krijuar nga pandemia e Covit 19, kërkesës se shtabit për emergjent komunal për parandalimin e pandemi, neneve 12.2 pika d nenit 40 pika e të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Ndarjen Buxhetore që kanë të bëjnë me ndihmat emergjente në situatën e krijuar. Pra, kryetari i komunës propozon këtë propozim vendim, gjithëherë duke u bazuar në situatën emergjente dhe gjendjen ekonomike të banorëve të Komunës së Vitisë, të lejohen mjetet financiare nga kategoria ekonomike për shërbime dhe mallra në shume prej 100 mije euro. Këto mjete do të mbuloohen nga nënprogrami

i qeverisë komunale, që kanë të bëjnë me programin 16033 të kryetarit të Komunës së Vitisë në shume prej 30 mijë euro, nenprogrami nga Drejtoria e Shërbimeve Publike 18193, 50 mije euro nga Drejtoria e Shëndetësisë, nënprogrami 74950, 10 mije euro dhe nga Drejtoria e Arsimit, nënprogrami 92165, 10 mije euro. Gjithsej pra shuma prej 100 mije euro, janë planifiku të financohen për këtë, situatë emergjente. Këto mjete do të shfrytëzohet për sigurimin e artikujve ushqimor, pakove të ndryshme, ndihmave higjienike për familjet në gjendej të rend ekonomike, dezinfektimin e hapësirave publike, furnizimin me mjete mbrojtëse nga Covid 19 dhe mbulimin e të gjitha nevojave tjera që dalin si rezultat i parandalimit të kësaj sëmundje. Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapi debat për këtë pikë.

**z.Nijazi Isaku:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht, ne me grupin e AAK-së kemi thirr një seancë të jashtëzakonshme, të premtën kemi bë kërkesë ligjore, ku një ditë mbrapa ne dakordim me kryesuesin, kryetarin, shtabin e emergjencës, ka qenë kërkesë e tyre, që përveç pjesës ne që e kemi definu, në rend dite ka qenë ndihma për familjet skamnore dhe asistencë sociale. Unë fillimisht du me i falenderu të gjithë infermierët, mjekët, policet që janë tu ballafaqu me këtë situatë dhe ata janë pjesë, që janë në ballë të kësaj pandemie dhe kam një falënderim të jashtëzakonshëm ndaj këtyre personave. Po ashtu falënderim për të gjithë qytetarët që po janë vigjilent dhe po i zbatojnë të gjitha udhëzimet dhe urdhrat që po vinë nga niveli qendror dhe ai lokal lidhur me situatën e pandemisë. Andaj edhe ne si grup i LVV-së, e mbështesim këtë propozim vendim.

**z.Bekim Azizi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! E dimi që jemi me një situatë që e ka kaplu të gjithë boten, një situatë në të cilën kërkohet një mobilizim me i përhershëm. Deri sa të mbaron kjo gjendje, në këtë situatë që kjo pandemi nuk njef as mosh, as gjini, as parti, as nacionalitet, as post politik, dhe gjitha këto na bëjnë që të jemi shume me të kujdesshëm dhe shume të jemi me të bashkuar, që së bashku ta kalojmë këtë sfidë, që kjo është për gjithë, një falënderim është i përhershëm për të gjithë ata që kontribuuan me se shumti, mjekët, policët, zjarrfikësit, organizatat humanitare dhe të gjithë qytetarët që kanë dhënë kontributin e vet, institucionet që kanë obligim. Ne e kemi obligim si kuvend komunal dhe çdo kush një punë të mirë që është tu e bë për me e kalu me letë dhe megjithatë edhe unë ju bashkohem ne emër të Partisë Demokratike, që t'i përmbahemi rekomandimeve që po i japin profesionistët. Kjo pandemi na ka bë që ne te mendojmë, që profesionistet duhet ta kenë përherë vendin e merituar, sepse ne kushtet ose rrethanat që janë të jashtëzakonshme, askush nuk e pam asnjëri tjetrin, sytë i kemi pas tek profesionistet, sepse vetëm me profesionist kalohen gjërat me mirë, prandaj mendoj që do të jetë një mësim për të ardhmen, prej fillimi kemi qenë në kontakt edhe me institucionet që kanë pas barrën me kryesore për ta udhëheq këtë dhe kemi ofru bashkëpunimit tonë si grup parlamentar dhe kemi kërku që në çdo moment që na mos të marrim iniciativa për ndarjen e mjeteve, po në çdo moment kur e shofim të arsyeshëm, që nevojiten mjete të caktuara dhe prapë po thomi, se nëse këto mjete që ndahen sot nuk do të jenë të mjaftueshme, prapë në çdo moment grupi i Partisë Demokratike do të jetë i gatshëm për të ju përgjigj dhe me nda mjete çdoherë që është e nevojshme për tejkalimin e këtyre sfidave. Të jemi shumë të kujdesshëm, se, me sa po shifet nuk do të jetë e shkurt, do të jetë me e gjatë kjo sfidë, do të përballmi pak me gjatë. Kjo tregon edhe çështja e organizimit të mësim, që ka fillu një çështje onlin, që tregon që një kohë të gjatë nuk do të jemi në formë të rregull, të përgatitemi për një rrugë më të gjatë. Ishalla kalon sa më lehtë, po të përgatitmi për një rrugë sa më të gjatë. Grupi jonë e përkrahim, vendimin nuk e ke specifiku, nuk ke një ndarje sa do të jenë për asistencë social apo sa do të jen për pjesën tjetër që do të bëhet dezinfektim e pajisje tjera. Mirëpo, mendoj që kjo punë do të rregullohet në bazë nevojës që është në të ardhëm dhe ne si grup e përkrahim këtë vendim për ndarjen e mjeteve prej 1000 mije euro për luftimin e kësaj pandemie.

**z.Vehbi Rama:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Këtë pandemi që e ka kap edhe Kosovën edhe tërë boten, është thirr kjo seancë e jashtëzakonshme, edhe sot nuk është von kjo iniciativë nga kryetari i komunës, që të bëhet shpërndarja, të ju nimojmë qytetarëve të Vitisë, edhe pse unë nuk po e shoh që janë specifiku këto 100 mije euro që po ndahen. Sa është vlere e pakove dhe çka duhet të ketë në at pako. Unë kam një propozim, që kjo pako të jete dikun vlere 50 euro. D.m.th 2000 familje nga 50 euro, shuma e përgjithshme 100 mijë euro. Në këtë pako kisha propozu të jete një familje që është me pesë anëtarë, të jepet një thes mill 25 kg, mbi 5 anëtar të jepet 50 gk, 5 kg sheqer, nga 5 pako file, makarona, vaj, viget, dizinfektues, 1 kg qaj dhe dikun të kenë edhe pampersa në ato familje që kanë fëmijë. Si do që të jetë, unë e përkrahi këtë propozim në emër te grupit të AAK-së.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse ka dikush tjetër të merr fjalën?

**z.Ekrem Abazi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmi! I kisha falënderu të gjithë ata njerëz që kanë kontribuar për këtë gjende të jashtëzakonshme që po e quajmë. Sa i përket ndarjes së 100 mijë euro për ndihmë për qytetarët e Komunës së Vitisë, mendoj që këto 100 mijë euro duhet të jepen vetëm për gjërat ushqimore dhe higjienike. Sa i përket gjerave të tjera, për maska, për dezinfektim, Komuna e Vitisë është komuna e parë që ka fillu me këtë sëmundje, d.m.th këtu duhet mu interesu Qeveria e Kosovës. Kemi shumë raste të vështira në Komunën e Vitisë dhe na i bëjmë apel qytetarëve, vetëm të rri në shtëpi. I kemi lodh qytetarët tu ju thanë rri në shtëpi. Po ata duhet diçka me hangër. Ekzistojnë persona që marrin ndihma sociale, fatmirësisht Qeveria e Kosovës e ka bërë një vendim shumë të mirë që ju ka dhënë edhe një pagë plus, po janë disa kategori tjera, p.sh.: kategoritë me aftësi të kufizuar, janë disa njerëz që për shkak të kushteve që i ka qit ministria nga qendra, që këto nuk mujn me i plotësu kushtet, me marr ndihma sociale. Nëse e ki një fëmij mbi 5 vjet, sun merr ndihma sociale. Vajhalli për neve çfarë njerëz e kanë pru këtë vendim. Ose, nëse nuk i ki të dy prindërit e sëmutë, sun merr ndihmë sociale. Janë një kategori që nuk kanë marr kurfar ndime, po nashta janë në gjendej me të vështirë se këta që marrin ndimë sociale. Një kategori e njerëzve që kanë punu në ndërtimtari ose punë krahu, muajin nëntor dhjetor ata nuk kanë marr asnjë cent, tash edhe tre muaj këtë vit, d.m.th që pesë muaj me një familje të varfur mos me hi asnjë cent. Ajo është shumë punë e ranë. Na e marrmi ka një pagë, e mos me marr menjëherë e ndiem mungesën, po ata që nuk kanë marr që pesë muaj pagë, është kogjo ran. Unë kërkoj që të formohet një komision prej të gjitha partive politike, ta shikojnë gjendjen mirë dhe t'i shpërndajnë këto pako dhe kërkoj rigorizisht të përgjigjen për çdo cent ku jepen, jo sikur hajt e blejta këtë me çmim të dyfisht. Nëse bëhet një komision, punët kanë me shku mirë. Sa i përket gjendjes, si po thuhet e jashtëzakonshme, mu nuk po me doket që është bash qashtu. Pse po e thamë këtë. Po me u pas kanë gjendja bash e jashtëzakonshme, nuk ish thirr mbledhja me e rrezu qeverinë, e janë tubu 120 deputet, e 200 vet aty, nuk i kanë pas gjendja e jashtëzakonshme, se nuk ishin mbledh aty. Për këto 100 mijë euro, le të jete një grup i të gjitha partive politike e jo vetëm drejtori i Financave edhe ndoshta me bë naj potezë edhe në këtë kohë, se na dimi me vjedh edhe prej përmendoreve të dëshmorëve edhe prej varrezave të dëshmorëve, na dimë me vjedh edhe në këtë kohë. Për qata është më mirë edhe për drejtorin mos me marr këtë përgjegjësi.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Ekrem, mundet me qenë një komision, i cili e përcjell ka janë shku ato, por meqë atë ti e dinë që janë dy çështje të ndara, është kuvendi i cili e bien vendimin dhe që e përcjell ka janë hargju dhe është ekzekutivi që e ka për obligim, nuk është as drejtori i financave, po as nënkryetari e as kryetari, është Zyra e Prokurimit. Në rast se kemi nevojë, ne e bëjmë në procedurë të përshpejtomë, vendosmi e shpallim tenderin, ju do të keni informacionet e mjaftuara. Këto para do të përdoren për nevojat e kësaj gjendje, nëse kemi nevojë për dorëza, do të blejmë dorëza, nëse kemi nevojë për maska, do të blejmë maska, nëse kemi nevojë për tesha mbrojtëse që shkojnë ata të infektuarit, duhet me ju siguru, prandaj nuk është mirë me u fukusu. Megjithatë krejt këto mjete janë të dedikuara rreth Korona Virusit, tu fillu prej mjeteve mbrojtëse, dezinfektimi, deri tek të mirat materiale. Aty ku kemi nevojë, ku na paraqitet nevoja, ne do të reagojmë.

**z.Ekrem Abazi:** Besoj që ligjet ekzistojnë, po kur është gjendja e jashtëzakonshme, nuk bënë me e keshyr bash ligjet qysh po thuani ju. Masi është gjendje e jashtëzakonshme, bënë këto mos me shku me tender, se nëse shkon me tender, ju keni me marr një thes mill 15 euro, atëherë kjo po vidhet në mënyrë direkte apo indirekte.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë! Unë e kam një shqetësim rreth listave të reja të familjeve në nevojë, për shkak se disa familje që nuk janë në asistencë sociale dhe për shkak që ka qenë edhe kohë dimri, nuk kanë pas mundësi me punu, edhe prej kësaj gjende i kisha lut këshillat e fshatrave të shikojnë listat e nevojtarëve në familjet me nevojë. Ne në Smirë e kemi bërë këtë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** I falënderoj edhe kryetarët e këshillave të fshatrave, të cilët janë tu e bërë një punë të mirë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu propozim vendimi. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shpresoj që sa më shpejt të kaloj kjo pandemi.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00 min.

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**